

Përshëndetje znj. A. K.,

Në vijim të kërkesës suaj për informacion, në kuadër të zbatimit të projektit “WeLead: EU Scheme for Young Professionals in the Western Balkans”, përsa i përket të dhënave që ju kërkon, Departamenti i Administratës Publike ju sqaron si vijon:

➤ **Lidhur me pyetjen e parë:**

1. Sa është numri total i punonjësve të administratës shtetërore (të ndarë nëpunës civile dhe Kod Pune)? Nëse nuk dispononi të dhënat e administratës shtetërore, lutem të dhënat për administratën publike.

Në pikën 2, të nenit 7, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, përcaktohen detyrat e Departamentit të Administratës Publike (DAP). Më konkretisht në këtë dispozitë parashikohet se: “2. DAP-i ka këto detyra:

- a) përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave shtetërore në shërbimin civil;
- b) përgatit projekt-aktet ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil;
- c) mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;
- ç) përgatit mendim për çdo projekt-akt të propozuar nga institucionet e tjera që ka të bëjë me marrëdhëniet e punësimit në administratën publike;
- d) miraton dhe ndjek zbatimin e programeve të trajnimit në shërbimin civil;
- dh) përgatit planin vjetor të pranimit për institucionet e administratës shtetërore;
- e) përfaqëson, së bashku me Ministrinë e Financave, Këshillin e Ministrave në negociatat dhe konsultimet për kushtet e përgjithshme të punës në shërbimin civil me sindikatat ose përfaqësuesit e nëpunësve civilë;
- ë) administron Regjistrin Qendror të Personelit;
- f) mbështet dhe siguron këshillimin e institucioneve në zbatim të këtij ligji;
- g) përgatit udhëzime të përgjithshme dhe manuale për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;
- gj) i paraqet Kryeministrit, me propozim të institucioneve të administratës shtetërore, strukturën dhe organikën e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë;
- h) në përputhje me legjislacionin në fuqi, harton dhe bashkëpunon për strukturën e pagave për nëpunësit dhe punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore;
- h/1) harton dhe miraton rekomandimet për politikën e trajnimeve të nëpunësve civilë.
- i) ushtron çdo kompetencë të dhënë nga ky ligj apo në bazë të tij.”

Për më tepër, në gërmën “a” dhe “f”, të pikës 1, nenit 4, të këtij ligji, përcaktohet se: “a) “Institucion i administratës shtetërore” është aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit f) “Njësi përgjegjëse” është Departamenti i Administratës Publike (DAP) për institucionet e administratës shtetërore dhe njësi e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore.” Për sa më sipër, referuar dispozitave të sipërcituara ku përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit, ju bëjmë me dije se DAP-i është njësi përgjegjëse vetëm për administratën shtetërore, përbërja e së cilës përcaktohet më lart.

Në çdo rast, fusha e veprimtarisë së institucionit shtrihet vetëm në shërbimin civil.

Në këto kushte, për sa i përket kërkesës tuaj për numrin e punonjësve që janë në marrëdhënie pune, përfshirë këtu dhe punonjësit që trajtohen sipas Kodit të Punës, ky informacion mund të disponohet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, e cila është ministria përgjegjëse që menaxhon buxhetin vjetor në Republikën e Shqipërisë.

➤ **Lidhur me pyetjen e dytë dhe të tretë**

2. A janë në zbatim apo planifikim programe për rekrutimin dhe mbajtjen e talentëve në administratën publike?
3. A po zbatohen programe në kuadër të Brain Gain? Cilat janë masat në kuadër të këtij programi dhe periudha kohore e zbatimit?

Në muajin maj të vitit 2023, Departamenti i Administratës Publike publikoi thirrjen për aplikim në programin “Ngritja e kapaciteteve për nëpunësit civilë të administratës publike, përfshirë trajnimet/praktikat dhe vizitat studimore në administratat e vendeve anëtare të BE-së (Qelizat e Reja). Programi “Qelizat e reja/“Young cells”, i financuar nga Bashkimi Evropian nën IPA II 2020, kishte synim t’i jepte mundësinë 25 nëpunësve civilë të administratës publike shqiptare të marrin pjesë në një program zhvillues për rritjen e kapaciteteve të tyre. Në këtë program përfshihen trajnime praktike, seminare dhe ëorkshop-e, vizita studimore dhe praktika pune në shkollat dhe administratat publike të 5 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (Francë, Itali, Gjermani, Greqi dhe Kroaci). Programi mbështet Qeverinë Shqiptare në reformën e shërbimit civil dhe kontribuon në zhvillimin e mëtejshëm të një administrate publike efëçente, efektive dhe transparente në Shqipëri. Ky program nisi në muajin shtator 2023 dhe do të përfundojë në fund të muajit prill 2024.

Ndërkohë, në zbatim të pikës 3, kreut II, të vendimit nr. 586, datë 30.08.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore” i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike do të shpallë procedurën për shprehjen e interesit për punësimin me kontratë të përkohshme 1 vjeçare të studentëve të ekselencës, për institucionet e administratës shtetërore) në pozicionet specialist dhe të barazvlefshëm në institucionet e administratës shtetërore, brenda vitit 2024.

➤ **Lidhur me pyetjen e katërt:**

4. Lutem të dhëna mbi Programin Kombëtar të Praktikave të Punës nga thirrja e parë deri në Dhjetor 2023 sipas tabelës më poshtë:

Bazuar në vendimin nr. 395 prot, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar, Programi Kombëtar i Praktikave të punës realizohet nga Ministria përgjegjëse për rininë. Kjo ministri administron procesin e punësimit të praktikantëve për çdo institucion të administratës shtetërore.

➤ **Lidhur me pyetjen e pestë:**

5. Lutem të dhëna mbi Thirrjen për të sapodiplomuarit studentë të ekselencës për institucionet e administratës shtetërore nga thirrja e parë deri në Dhjetor 2023:

Departamenti i Administratës Publike ka realizuar 5(pesë) thirrje për punësimin me kontratë të përkohshme 1 vjeçare të studentëve të ekselencës, nga viti 2019 deri në vitin 2022. Informacionin për tre thirrjet e para e gjeni të pasqyruar në raportet vjetore të publikuara në faqen zyrtare të DAP, në linkun <https://www.dap.gov.al/publikime/raporte-vjetore> .

Ndërkohë në prill të vitit 2022, në zbatim të vendimit nr. 665, datë 10.11.2021, të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë në vendimin nr. 586, datë 30.08.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, i ndryshuar, të gjithë të përzgjedhurit nëpërmjet platformës “Gati për Shqipërinë”, përjashtimisht për vitin 2021, iu dha e drejta të përzgjidheshin dhe të sistemoheshin me prioritet në pozicionet e dedikuara për studentët e ekselencës. Në platformën “Gati për Shqipërinë”, aplikuan 190 kandidatë, 42 prej të cilëve nënshkruan kontratën 1 vjeçare në institucionet e administratës shtetërore.

Në korrik të vitit 2022, në zbatim të pikës 3, kreut II, të vendimit nr. 586, date 30.08.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike shpalli thirrjen e pestë për shprehjen e interesit për punësimin me kontratë të përkohshme 1 vjeçare të studentëve të ekselencës, në pozicionet specialist dhe të barazvlefshëm në institucionet e administratës shtetërore. Numri aplikantëve për këtë thirrje ishte 337, ku 57 prej tyre nënshkruan kontratën 1 vjeçare të punës. Informacionin e gjeni të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Numri i thirrjeve dhe periudha kohore	Numri i aplikantëve	Numri i studentëve që nënshkruan kontratën 1-vjeçare	Numri i studentëve që vijuan marrëdhënien në administratën publike në përfundim të kontratës 1 vjeçare
Thirrja I (4 mujori i parë i 2019)	1207	459	286
Thirrja II (4 mujori i dytë i 2019)	743	143	88
Thirrja III (nëntor 2020-janar 2021)	696	92	59
“Gati për Shqipërinë” (prill 2022)	190	42	
Thirrja V (korrik 2022)	337	57	

Në përfundim të kontratës 1 vjeçare në institucionet e administratës shtetërore, Departamenti i Administratës Publike vijon procedurat e konkurrimit për pranimin në shërbimin civil për pozicionet të cilat ishin të plotësuara nga studentët ekselentë të dy thirrjeve të fundit.

Përsa i përket institucioneve ku studentët ekselentë të tre thirrjeve të para vijojnë marrëdhënien e punës pas kontratës 1 vjeçare, janë si më poshtë:

1. Administrata e Prefektit të Qarkut Dibër
2. Administrata e Prefektit të Qarkut Durrës
3. Administrata e Prefektit të Qarkut Elbasan
4. Administrata e Prefektit të Qarkut Fier
5. Administrata e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë
6. Administrata e Prefektit të Qarkut Kukës
7. Administrata e Prefektit të Qarkut Lezhë
8. Administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër
9. Administrata e Prefektit të Qarkut Tiranë
10. Administrata e Prefektit të Qarkut Vlorë
11. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
12. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
13. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
14. Agjencia Kombëtare Bërthamore
15. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
16. Agjencia Kombëtare e Bregdetit
17. Agjencia Kombëtare e Diasporës
18. Agjencia Kombëtare e Falimentimit
19. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
20. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
21. Agjencia Kombëtare e Mjedisit
22. Agjencia Kombëtare e Pyjeve
23. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
24. Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
25. Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor
26. Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
27. Autoriteti i Aviacionit Civil
28. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
29. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
30. Departamenti i Administratës Publike
31. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
32. Drejtoria e Përgjithshme Detare
33. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
34. Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
35. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
36. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
37. Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë
38. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
39. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

40. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale
41. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
42. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
43. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë
44. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
45. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
46. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
47. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhënj
48. Drejtoria Rajonale Tatimore Berat
49. Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër
50. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë
51. Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës
52. Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër
53. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
54. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
55. Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politike
56. Instituti i Mjekësisë Ligjore
57. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
58. Instituti i Transportit
59. Komiteti Shqiptar i Birësimeve
60. Kryeministria
61. Ministria e Arsimit dhe Sportit
62. Ministria e Brendshme
63. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
64. Ministria e Drejtësisë
65. Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
66. Ministria e Financave dhe Ekonomisë
67. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
68. Ministria e Kulturës
69. Ministria e Mbrojtjes
70. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
71. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
72. Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore
73. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqesore Fushë-Krujë
74. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqesore Korçë
75. Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqesore Vlorë
76. Qendra Kombëtare e Biznesit
77. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar